



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.616/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaçi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevc, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në ndërtesë publike, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 14.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.616/2021 e datës 13.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, t'i shqiptohet gjobë për shkak të vendosjes së posterit në ndërtesë publike, për Zgjedhjet Lokale 2021 që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesës me numër A.nr.616/2021 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 13 tetor 2021, rreth orës 12:00 aktivistet e saj kanë vërejtur se kandidati me numër 3 në listë për kuvendin komunal nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje Berat Lahu, ka shpërndarë material zgjedhor (baner), në kundërshtim me nenin 33 pika b), të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës pretendon se në lagjen “Dardania” i njëjti ka shpërndarë material zgjedhor në hapësirë të pa lejuar gjegjësisht në hapësirë të jashtme publike – ndërtesë, godinë. I njëjti kërkon që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se baneri i cekur në ankesë është i vendosur në pjesën e jashtme (dritaren) të njësisë banesore –banesë e cila është në pronësi të Mujë Halilit, ku në këtë rast kandidati i subjektit politik Berat Lahu për vendosjen e këtij baneri ka lidhur marrëveshje me pronarin e kësaj banese, për shfrytëzimin e hapësirës së jashtme të njësisë

banesore–banesës së përmendur në ankesë. Si dëshmi ka bashkangjitur marrëveshjen e datës 20 shtator 2021, lidhur në mes të pronarit të banesës Mujë Halilit dhe kandidatit Berat Lahu, për shfrytëzimin e njësisë banesore SU 5/10, Nr.111, në rrugën Idriz Gjilani, për vendosjen e posterit në këtë hapësirë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar,**

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit lëndor i kandidatit për Kuvend Komunal të Prishtinës Berat Lahu nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është i vendosur në hapësirën e jashtme të njësisë banesore–banesës, me pëlqimin e dhënë nga pronari i kësaj njësie banesore-banesës.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të dispozitës së nenit 33 pika b), të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, pasi që posterit në fjalë është vendosur në hapësirën e jashtme të njësisë banesore–banesës, me lejen e pronarit të banesës Mujë Halili, i cili me datën 20 shtator 2021 ka lidhur marrëveshje për shfrytëzimin e hapësirës private për vendosjen e posterit të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës Berat Lahu, e cila vërtetohet nga provat e bashkangjitura në përgjigje në ankesë nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa sa i përket pretendimeve të paraqitësit të ankesës për shkeljen e dispozitave të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, të njëjtat u refuzuan si të pabazuara, për faktin se dispozitat të cilat paraqitësi i ankesës pretendon se janë shkelur nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk e sanksionojnë shkeljet e tilla në rastet kur ekziston leja e pronarit për vendosjen e tyre.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.616/2021 më datë 14.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.